


Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse



**Memo:** Mbi shtesën dhe ndryshim e rregjistrit e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2023.

**Për:** Z. Dhori Dapi, Drejtor i Përgjithshëm

**Për dijeni:** Njësisë së Prokurimit

Me shkresën e MIE me nr. 861/1 prot, datë 25/01/2023 "Dërgohet miratimi i buxhetit për shpenzimet korente për vitet 2023-2025", është dërguar nga MIE miratimi i buxhetit për shpenzimet korente për vitin 2023. Institucioni sipas legjislacionit në fuqi, deri më 30 janar 2023 duhet të hartonte e publikonte Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023. Rregjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023, me shkresën Nr 172 prot, date 30/01/2023 i është njoftuar MIE, Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Degës së Thesarit Tiranë. Në Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023, kërkojmë të bëhen shtesa dhe ndryshimi i argumentuar si më poshtë:

**I. Mbi shtesën e Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për investimet publike të planifikuara për vitin 2023**

Me shkresën e MIE me nr. 1360/2 prot, datë 15/03/2023 "Dërgohet miratimi i buxhetit për shpenzimet kapitale për vitet 2023-2025", institucionit tone i janë planifikuar për vitin 2023 fondet në shumën 2.000.000 lekë, për projektin: "Blerje aparatura e paisje teknologjike e paisje pune profesionale për nevoja të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar".

Këto fonde, për shkak të akordimit të tyre më 15 mars 2023, nuk janë përfshirë në Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023.

Aparaturat teknologjike që do të blihen me keto fonde të planifikuara janë të nevojshme për Laboratorin e Analizave Kimike. Për investime nga fondet buxhetore të vitit 2023, kërkojmë nga Njësia e Prokurimit, shtimin e publikimin këtij zëri në Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023, sipas shkresë së MIE të cituar sa më sipër si më poshtë:

NR	ZËRAT E SHPENZIMEVE	Vlera totale	Vlera pa tvsh
1	Blerje aparatura e paisje teknologjike e paisje pune profesionale për nevoja të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar	2,000,000	1,666,667
<b>SHUMA SHPENZIME Kapitale BUXHETI</b>		<b>2,000,000</b>	<b>1,667,667</b>

**II. Mbi ndryshim e Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për shpenzimet operative të planifikuara për vitin 2023**

Në Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023, janë planifikuar dhe zërat si më poshtë:

NR	ZËRAT E SHPENZIMEVE	Vlera totale	Vlera pa tvsh
31	Blerje gaz acetilen e oksigjen për Laboratorin	120,000	100,000
32	Blerje gaz argon për Laboratorin	200,000	166,667
	TOTALI	320,000	266.667

Duke qenë se këto dy zëra janë të ngjashëm me njëri tjetrin, janë blerje gazi acetilen, gazi argon dhe oksigjen të pastër të nevojshëm për funksionimin e aparaturave për kryerjen e analizave të ndryshme kimike në Laboratorin e Analizave Kimike, kërkojmë ndryshimin e tyre duke i bashkuar në një zë të vetëm si më poshtë:

NR	ZËRAT E SHPENZIMEVE	Vlera totale	Vlera pa tvsh
31	Blerje gaz acetilen, gaz argon e oksigjen për Laboratorin	320,000	266.667
	TOTALI	320,000	266.667

Per sa me sipër kërkojmë nga Njësia e Prokurimit, shtesën dhe ndryshimin në Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023.

Shënim: Shtimi dhe ndryshimi i Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2023, kërkohet me vonesë pasi nga data 9 shkurt ishim pa titullar institucioni, për shkak të daljes në pension të Drejtorit të Përgjithshëm. Me Urdhrin me nr. 61, datë 18.05.2023 "Për ushtrimin e përkohshëm të funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", të Zv. Kryeministër dhe Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. Dhori Dapi, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Lejeve të Kërkim Zbulimit në Drejtorinë e Burimeve Minerale, ngarkohet që krahas detyrave funksionale, të ushtrojë përkohësisht funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

**Tiranë më 30/05/2023**

**Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**

Nafie Gjapi

